

LAW OFFICE OF VIRTYT IBRAHIMAGA

Attorney at law & Insolvency administrator

LAW OFFICE OF VIRTYT IBRAHIMAGA
Str. Fehmi Agani no.: 1/16 · 10010 Prishtina

II. Nr. 316/2020

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË DEPARTAMENTI PER ÇËSHTJE EKONOMIKE

Për

GJYKATËN E AELIT, PRISHTINË

Federata Sindikale e PTK-së, Llagja Dardania p.n., Prishtine

- Paditësja/Propozuesi -

Dardafon.net LLC me seli ne rr. Dëshmori, fsh. Miradi e Epërme, Fushe Kosove, e përfaqësuar nga Avokat Virtyt Ibrahimaga, Rr. Anton Çetta 5a, 10000

- E Paditura/Kundërshtarja e Propozimit -

Konfrom aktvendimit të Gjykatës Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike te datës 28.07.2020 të pranuar nga e paditura me datë 29.07.2020, e Paditura parashtron këtë

PËRGJIGJE NË ANKESE

A) Afatshmëria e ankesës

Propozuesja e masës se sigurimit ka ushtruar ankese kundër Aktvendimit te Gjykates se Shkallës së Pare me datën 31.08.2020. Kundërshtarja e Propozimit e ka pranuar Aktvendimin e atakuar me datë 17.08.2020. Prandaj kërkojmë qe Gjykata sipas detyrës te shqyrtoj nëse

Virtyt Ibrahimaga
Attorney at law & Insolvency administrator
Str. Fehmi Agani no.: 1/16 · 10010 Prishtina

VAT. No.: 330222894

Tel.: + 381/38 227 358
Fax: + 381/38 222 773
info@lawfirm-vi.com
www.lawfirm-vi.com

Raiffeisenbank Prishtine
Acc. no.: 1501 1100 0095 1351
IBAN: XK05 1501 1100 0095 1351
Swift Code: RBKOKKPR

2020
2020 SEP - 8 AM 11: 40
MR. SHKR. BRSPISA
GJYKATA THEMELORE
OSNOVNI SUD
PRISHTINE, PRISTINA
PRANUAR TRILJENO

ankesa është pashtuar brenda afatit kohore dhe të refuzojë Aneksen të palejueshme, në rast se e njëjta është dorëzuar jashtë afatit ligjor.

B) Ankesa është e pabazuar

1. Aktvendimi është i arsyetuar

Pretendimet e Propozuesës së masës së Gjykata e shkallës së parë nuk e ka argumentuar vendimin e saj janë tërësisht të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar gjerësisht vendimin e saj. Propozuesja e masës së sigurimit gjerësisht në mënyrë abstrakte ka elaboruar nenet e ligjit, por nuk e treguar se në cilën pikë Gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar.

2. Kushtet e parapara me nenin 297 të LPK nuk janë plotësuar

Besueshmëria e kërkesës: Propozuesja e masës së sigurimit konsideron se Pasia e saj është e bazuar dhe Gjykata duhet të miratojë propozimin për masë të sigurisë. Propozuesja nuk e ka të qartë se fakti se ajo mendon se ka kërkesë të bazuar nuk është kriter mbi të cilin gjykata mund të nxjerrë vendim.

Propozuesja ka iniciuar padi për anulimin e një kontrate të vitit 2010 të lidhur në mes të dy ndërmarrjeve në Kosovë, e cila është shkëputur nga njëra pale në Korrik 2019. Propozuesja konsideron se kjo kontratë ka shkelur rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë. Megjithatë e njëjta nuk ka treguar se për çfarë arsye kjo kontratë e shkelur rendin publik ose dispozitat urdhëruese ose moralin e shoqërisë. Kjo kontratë është nënshkruar nga dy ndërmarrje legjitime dhe objekti i kontratës ka qenë i lejuar. Dispozitat e kontratës janë negocuar gjatë dhe me ndihmën e profesionistëve të juridik dhe ekonomik.

Paditësja pretendon se kjo marrëveshje ka qenë e dëmshme për njërin pale të kësaj kontrate. Fillimisht duhet cekur se ky pretendim nuk mund të arsyetohet nënligjetor në një kontratë. Por edhe sikur ky të ishte rasti, ky pretendim është tërësisht i pabazuar në padi. Propozuesja i dëshmi ka paraqitur një sërë artikuj gazetalesh dhe opinione publike, por asnjë provë. Opinione publike nuk janë dëshmi. Duhet theksuar se kjo kontratë ka qenë objekt i atakimeve të shumta publike me qëllim që problemet reale të Telekomit të Kosovës të mbulohej duke e diskredituar një kontratë të vetme. Megjithatë, në secilën procedurë gjyqësore është vërtetuar se kjo kontratë ka qenë kontratë e rregullt. Në vitin 2012, nga vet qarqet e Telekomit të Kosovës ishte bërë një kallxim penal në prokurori për hyrje në kontratë të dëmshme. Në bazë të këtij kallximi penal ishte ngritur aktakuze me numër 279/12 kundër ish shëtit të Telekomit dhe zyrtarëve të Kundërshatres së propozimit. Kjo procedurë përfundoi me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të datës 28.06.2013 në Prishtinë e përbërë nga gjykatës të EULEX duke i liruar të akuzuarit nga secila akuzë dhe duke konkluduar se kontrata nuk është e dëmshme për Telekomit të Kosovës. Në vitin 2014 nën presionin e brendshëm Telekomit të Kosovës vendosi që mos t'i

ofroj Kundërshtares se propozimit shërbimet 3 dhe 4G. Kundërshtarja e propozimit iu drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit dhe e fitoj kontestin, ekzekutimin e të cilin vendim Propozuesja me metoda jokonvencionale është duke tentuar ta pengoj. Pra kjo kontratë ka qenë objekt i shqyrtimit edhe në procedurën civile. Ky vendim u njoh dhe u shpall i ekzekutueshëm nga Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike përmes aktvendimit V C- 388/18 të datës 11.02.2018, pasi që i shqyrtoj edhe pretendimet e Telekomit lidhur me përçueshmërinë e këtij vendimi me rendin juridik në Kosovë.

Tani, Propozuesja pa e bërë të qartë interesin e saj juridik kërkon që një Gjykatë e Kosovës në mënyrë retroaktive të shpallë kontratën lartcekur si nulë, me qëllim që të parandalohet ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit i cili është në procedurë përmbarimore.

Propozuesja në këtë procedurë pretendon t'i mbroj interesat Telekomit të Kosovës me mirë se ajo vet, në një procedurë në të cilën Telekomit i Kosovës nuk është fare. Propozuesja e sigurimit pretendon se një kontratë është e dëmshme për një palë tjetër, edhe pse kjo kontratë ka qenë objekt i shqyrtimit edhe në procedurë penale dhe në procedurë civile. Propozuesja konsideron se përmes iniciativave ekzotike gjyqësore mund të parandalohet ekzekutimin e një vendimi gjyqësorë të formës së prirë dhe t'i dëshmojë publikut se ajo është me e zoja se vet pala kontraktuese, gjegjësisht Telekomit i Kosovës. Krediti publik që propozuesja e kërkon përmes kësaj procedurë bëhet edhe me i qartë për faktin që Propozuesja investon shumë në bërjen publike të peripecive të saj për "të mbrojtur interesat e Telekomit të Kosovës" dhe politizimin e një çështje që është tërësisht e natyrës juridikë. Propozuesja konsideron se qëllimet e saja jo fort transparente mund t'i arrijë përmes kësaj procedurë dhe kërkon legjitimitin përmes gjykatave.

Kërkesa për masë të sigurisë i nënshtrohet kushteve ligjore dhe objektive dhe dëshirave të një palë. Bazueshmëria e kërkesëpadisë, si njëri nga kriteret e keti neni nuk mund të vërtetohet sipas pretendimit të një palë, por ky kriter sipas nenit 297 të LPK kërkon që bazueshmëria e kërkesës të bëhet në atë masë e besueshme që kërkesëpadija *prima facie* të jetë e sukseshme. Propozuesja këtu nuk e ka bërë me asnjë dëshmi të vetme dhe asnjë elaborim të dispozitës në të cilën ajo vet thirret. Propozuesja ka nxjerrë shumë paushalle të një demit që në fakt nuk ka eksistuar fare dhe nuk është vërtetuar nga asnjë organ i pavaruar dhe kërkon që në bazë të këtij demit të supozuar "të shkaktuar" një palë tjetër kontraktuese të shpallet në mënyrë retroaktive një kontratë e lidhur para 10 vitesh. Për çfarë arsye një kontratë e lidhur nga dy subjekte i përbush kushtet për të qenë nulë sipas nenit 89 të LMD, është tërësisht e paqartë. Për më tepër Propozuesja e shpreh qartas qëllim e saj që nuk ka ndonjë interes në çështjen e iniciuar me kërkesëpadi por në konsekuencat nëse një masë e sigurimit, ndalimin e përmbarimit të një vendimi gjyqësor.

Mosekzistim i se drejtës subjektive: Propozuesja nuk e ka dëshmuar ekzistimin e se drejtes se saj subjektive. Propozuesja nuk ka interes juridik ne kete ceshtje, sepese interesat qe ajo i pretendon i takojnë nje pale tjetër, Telekomit te Kosoves. Interesi i vertete i Propozueses, qe ne kete rast eshte tërheqja vëmendjes publike, gje qe nuk është interes qe gëzon mbrojtje juridike.


Rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë, Propozuesja do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës gjithashtu nuk ekziston. Kërkesëpadia ka te beje me shpalljen nule te nje kontrate dhe realizimi i kësaj kërkesë nuk eshte ne rrezik. Propozuesja konsideron qe mjetet mund te tjetërsohen, por cili eshte interesi juridik i Propozueses? Propozuesja nuk e ka te qarte se permes kërkesës se saj eshte duke i prekur interesat e palëve te tjera dhe jo interesat subjektive te saj. Rezultati i nulitetit te kontratës nuk do te bënte te pavlefshëm nje vendim gjyqesor te formës se prere, por do t'i obligonte palët qe te kthejne ate cka kane fituar nga shërbimet e tyre kontraktuese. Ne kete te dyja palët kane përfituar nga njëra tjera dhe obligimi i kthimit do te vlente nga për te dyja palët dhe nuk besojmë qe kjo do te ishte e favorshme për asnjërën pale.

Ankesa e Propozueses është tërësisht e pabazuar, prandaj i propozojmë Gjykatës qe te nxjerre kete

AKTVENDIM

- 1) Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Propozueses se Masës se Sigurimit Federata Sindikale e PTK Federata kundër aktvendimit te Gjykatës Themelore, Departamenti per Ceshtje Ekonomike te datës 10.08.2020.
- 2) Obligohet Propozuesja e masës se sigurimit Federata Sindikale e PTK-së ti barte shpenzimet e procedurës

Prishtinë, datë 04.09.2020


Virtyt Ibrahimaga

Avokat

Avokat · Attorney at law
Virtyt Ibrahimaga LLM.
Anton Cetta 5a, 10000 Prishtinë
Tel. 038 227 358; Fax: 038 222 773
Email: info@lawfirm-vi.com

Republika e Kosovës
Prishtinë
U Pranu në Gjykatën Themelore - Departamenti për Çeshtje Ekonomike
Në Prishtinë më 08.09.2020
Prilijeno me Osnovnom Siglu - Denagatomeni za Prizma Ekonomije
Dorezuar Predato 9154352
Me 2 kopje me Shtojca
Në 1 Primeraka sa Prilozima
Të ekspozuar